



Dalës-izlaza:

Nr. -1-217
Br. _____

Data 19.12.2019
Datum _____

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI²⁹, mbledhja e 15) me dt.27.12.2019 (e premte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:


R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi i Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
4. Formimi i Komisionit komunal për hartimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për themelimin e Ansambllit komunal të Qytetit të Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së DBZHR-së, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në Mazgit, për ndërtimin e një çerdheje publike me fonde të BE-së
7. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të shkollës së gjimnazit "17 Shkurti"
8. Shqyrtimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari" objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për Propozim vendimin për tatimin në pronë për vitin 2020
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.25.11.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlja (LDK), Fatmir Bektashi (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma) Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal, Slavisa Adjancic, shef i ZKKK-së, Drita Hashani, zyrtare ligjore, Myrvete Paloja, kordinatore për integrim, Ali Nimani, zyrtar i lartë për trashëgimi kulturore, perf.e KFOR-it, perf.e OSBE-së dhe perf.i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari", objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
4. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e draft planit komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
5. Shqyrtimi i draft Statutit të Komunës së Obiliqit
6. Raporti i Komisionit komunal sipas vendimit :Nr.I-170
 - a. Raporti me nr. X-1054 te datës 04.11.2019
 - b. Raporti me nr X-1087 të datës 11.11.2019
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua unanimitisht nga të gjithë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Linda Sadiku dhe Samire Berisha me arsye.

Pika 2 e rendit të ditës

Aziz Bici –Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar dhe kërkon të ketë më shumë kujdes sepse shpeshherë fjalitë po dalin pa logjikë dhe pa kuptim. Unë kur kam diskutuar kanë qenë 2 çështje shumë të ndryshme, por janë trajtuar si një e vetme. Fjala është kur e kam diskutuar çështjen e mbipopullimit në fshatin Plemetin, ndërsa çështja tjetër ka qenë rreth kanalizimit në fshatin Mazgit i Ulët.

Armend Rushiti – Unë nuk kam vërejtje, por pyes pse nuk ka ardhë procesverbali nga mbledhja e parafundit.

Kryesuesi – Sqaron se në atë mbledhje zyrtarja ka qenë në pushim dhe e ka zëvendësuar znj.Suzana Hashani, e cila ende nuk e ka kryer atë procesverbal.

Miratohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Fjalën ia dha zyrtarit të DKRS-së, për sqarim rreth draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive “Adem Jashari” objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq.

Ali Nimani – Drafti ka ardhë si rezultat i kërkesave të shtuara për shfrytëzimin e objekteve sportive dhe në këtë draft Rregullore janë inkorporuar gjithsejt 19 nene, do të thotë iu kanë shtue edhe 5 nene, që parashihet për administrimin e dhënies në shfrytëzim të këtyre fushave.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për e miratuan dhënien në diskutim publik të draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës sportive “Adem Jashari” objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet kërkesën nga ZKKK-ja, përmes DSHMS-së, për dhënien në diskutim publik të draft Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.

Aziz Bici – Për mua është shumë e paqartë dhe edhe pse po shkon kjo pikë e rendit të ditës për shqyrtim për debat publik, mendoj se ne sot duhet të kemi parasysh se a do ta votojmë apo jo sepse shumë gjëra këtu janë të paqarta.

Pasi që e lexoi te hyrja, pasuesin e fundit dhe te faqja nr.8, objektivin specifik të dytë pyeti këtë specifike nuk e kam dëgjuar asnjëherë kush janë këta, do të thotë duhet të jenë shumë të qarta që ne me ditë me votue. Sot është mirë me na sqarue këtë çështje. Për mua janë 2 gjëra të paqarta dhe kërkoj sqarim prej juve çka nënkupton akronimi GC dhe te objektivi specifikun e 5, fq.25, çka është kategori specifike.

Myrvete Paloji –Përgjegjet se ne mund të ju dërgojmë juve Rregulloren nr.2017/13, dhe në Rregullore shkruan se rastet specifike janë rastet e nënave vetëushqyese, fëmijët pa 1 prind, fëmijët pa 2 prindë, fëmijët me sëmundje kronike, do të thotë janë kategori që ndahen në familje me i ndihmue. Ndihamat jepen nga MPB-ja, por banorët e Komunës tonë duhet të lajmërohen në zyren për riintegrim. Ne jemi vetëm një urë kaluese që e grumbullojmë dokumentacionin për me ia dërgue MPB-së, departamentit të riintegrimit për personat e riatdhesuar. Shkurtesa GC, mund të jetë gabim teknik. Rastet sociale janë familjet me fëmijë nën moshën 5 vjeçare, që ne i drejtojmë në QPS, me iu ndihmue.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e miratuan dhënien në diskutim publik të draft Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.

Pika 5 e rendit të ditës –

Kryesuesi – Për një sqarim më detal fjalën ia dha znj.Drita Hashani, Kryetare e Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës.

Drita Hashani – Ju njoftoj se Draft Statuti ka dalë në diskutim publik me dt.9.08.2019 dhe është mbajtur takimi me qytetarë me dt.2.09.2019, në sallën e Kuvendit komunal. Gjatë debatit me qytetarë ne kemi pranuar disa propozime, si te neni 5, është propozuar që për festat e Komunës të përshkruhen edhe aktivitetet, por ne nuk kemi bërë ndryshim te festat e Komunës. Te kapitulli 2, neni 11, te vendbanimet është propozuar se vendbanimi dhe fshatrat janë një dhe ne s’kemi pasë mundësi ta ndryshojmë këtë, por kemi vepruar sipas ligjit. Te Komitetet konsultative dhe Këshilli i ekspertëve ishte propozimi të fshihet pasi që

përsëritej 2 herë dhe kjo nuk është marrë parasysh sepse s'ka të bëjë me Komitetet e përhershme. Te neni 64, është një pausë që thotë se drejtorët marrin përgjegjësi edhe nga Kuvendi dhe propozimi ishte se Kuvendi nuk jepë detyra, por vetëm Kryetari dhe këtë propozim ne nuk e kemi marrë parasysh. Te zyret dhe njësitë, ishte propozimi që arhiva të ndahet nga shërbimi me qytetarë dhe të jetë si njësi në vete. Ne kemi diskutuar me sektorin e administratës dhe është menduar që arhiva njëherë të mbetet kështu si është, pastaj do të vendoset si sektor i veçantë. Poashtu, ishte propozimi që në përshkrimin e Drejtorive, të futen edhe sektorët që janë nëpër Drejtori dhe Komisioni ka menduar se kjo duhet të rregullohet me Rregullore të veçantë. Në Statut janë emëruar të gjitha nenet që përpara nuk kanë qenë, te neni 1 i Statutit janë shtuar edhe 2 dispozita. Te neni 5 kanë qenë 2 dispozita, ndërsa tani janë 4, dhe në dispozitën 3, është shtuar fjala vendim. Te neni 8 i Statutit, tani neni 7 ka të bëjë me selinë e Komunës së Obiliqit, ndryshon adresa sepse tash jemi në rr. "Adem Jashari" dhe është mirë ta dimë tash se cili është numri i Komunës. Te neni 10 i Statutit të vjetër, tashmë është neni 9, ndahet në 2 dispozita dhe i shtohet komplet dispozita e parë që ka të bëjë me emërtimin e nenit: "Qytetar i Komunës së Obiliqit është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës, e që jeton në Komunën e Obiliqit". Kapitulli 3, neni 11, Statuti i vjetër tani rregulluar me nenin 10, Drejtorja e administratës ka kërkuar nga Komisioni që të bëhet harmonizimi i vendbanimeve pasi që në Statut ndryshon nga emërtimi i regjistrimit civil. Ne si Komision iu kemi drejtue MAPL-së dhe kemi marrë përgjegje se duhet të bazohemi në Ligjin nr.03/L-041, për kufijt administrativ.

Kryesuesi – Ju njoftoj se sot zyrtarisht na ka ardhë adresa dhe sipas DPUKP-së, numri i Komunës është 29.

Hysni Mjeku – Unë si anëtar i Komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, mund të them se kemi punuar disa ditë dhe kemi shfletue shumë Statute të Komunave tjera. Pastaj, kemi ardhë në përfundim se ndryshimet dhe plotësimet e paraqitura të Statutit janë konform Ligjit të administrimit të pushtetit lokal Preambula, ose pjesa hyrëse është plotësisht e mbështetur në Ligjin e administrimit të pushtetit lokal, dispozitat e përgjithshme dhe poashtu, dispozitat kalimtare. Ne nuk kemi mund të bëjmë ndryshime tjera sepse janë ligjet specifike që i rregullojnë lëmitë përkatëse. Unë kam shfletue shumë Statute, sidomos Statutin në Komunës së Gjakovës, të Mitrovicës dhe Ferizajit, por ju them sinqerisht se draft Statuti mund të aprovohet dhe të funksionalizohet. Një falenderim publik shkon për Kryetaren e Komisionit znj. Drita Hashani, e cila e ka pasë barrën kryesore në aspektin procedural dhe ligjor më tepër se ne anëtarët e Komisionit. Unë kam edhe një vërejtje publike se ne anëtarët e Komisionit, ndoshta kemi munguar nganjëherë me arsye, apo pa arsye, por mbi të gjitha e kemi kryer obligimin që kemi marrë nga Kuvendi komunal.

Aziz Bici – Unë kur kam qenë 2 herë i ftuar, më heret ka qenë edhe debati me kompaninë Apollonia në të njejtën kohë dhe një herë ka pasë problem me telefonin që aty për aty jam thirrë dhe nuk kam pasë kohë me marrë pjesë. Ndërsa, me ftesë kam qenë me kohë i ftuar në Shqipëri për trajtimin e Statutit dhe arsyen time ju veç e dini se unë nuk marrë pjesë sepse mendoj se duhet kursyer mjetet pasi që kemi mund këtu me bë. Unë flas rreth nenit 45, te zgjedhja e anëtarëve të KPF-së, në ligj thuhet se sa më të përfaqësuara duhet të jenë këto Komitete, ndërsa te pika 3, thuhet se numri i anëtarëve të KPF-së, përbëhet prej 5-7 anëtarë, do të thotë është e caktuar në këtë Statut. Unë konsideroj se kjo duhet të zëvendësohet në formën se KPF-ja duhet të përfaqësohet së paku me 1, a më shumë anëtarë nga të gjitha subjektet politike, që janë pjesë e Kuvendit komunal. Për me marrë edhe një shembull që mendoj se kam të drejtë në nenin 46, te zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për komunitete, pika 2 thotë se numri i anëtarëve të Komitetit për komunitete duhet të ketë 7-9 anëtarë. Edhe këtu, duhet të zëvendësohet me të njejtën qysh e thashë te KPF-ja dhe në rast se ju mendoni se në këso fome nuk mundeni me qeverisë prej këtij Statuti delë edhe Rregullorja, që mendoj se në Rregullore ndoshta e keni mundësinë me caktue qysh ua merrë mendja, që me qenë sa më të suksesshëm.

Kryesuesi – Sqaron se është Udhëzimi administrativ për themelimin dhe kompetencat e Komiteteve obligative, për KPF-në dhe Komitetin për komunitete, do të thotë KPF-ja duhet ti ketë prej 5, ose 7 anëtarë. Mirëpo, nëse ka më shumë përfaqësim politik në Kuvend se numri i anëtarëve të Komitetit, atëherë merret numri proporcional i zgjedhjeve të fundit dhe numri i anëtarëve të Kuvendit sipas përfaqësimit politik. Ju e dini se ne jemi detyrue me rishqyrtue për shkak të kuotës 50 %, meqë Ligji për barazi gjinore nuk është ligj

specifik, por Ligji për zgjedhjet është ligj specifik.

Aziz Bici – Unë iu referova ligjit dhe në ligj thuhet se duhet të jenë të përfaqësuar, do të thotë atëherë ju kur e keni marrë vendimin që subjektet tjera politike të kenë 2, apo më shumë dmth jeni në kundërshtim me ligjin, do të thotë nuk e keni mundësuar që të mbeten të përfaqësuar prej të gjitha subjekteve tjera politike.

Kryesuesi – Sqaron se kur në Komitet ka më shumë etni politike se anëtarë të Komitetit shkon përfaqësimi në bazë të numrit të përqindjes.

Nazmi Gashi – Ne sipërfaqësisht kemi ndryshue diçka, kemi pasë një takim pune lidhur me Statutin dhe jemi përcaktue, të gjithë e kemi thënë se Statuti është akti më i lartë, është Kushtetuta e Komunës. Unë pasi e kam një përvojë nga puna në administratë mendoj se në disa Drejtori është bërë ngatërrim në përshkrimin e detyrave të punës dhe nuk është e definuar qartë se cila Drejtori me cilat detyra pikërisht duhet të merret. Në fillim të caktimit të detyrave të Drejtorive, është dashur të caktohen cilat ligje dhe Rregullore ajo Drejtori i zbaton, për me qenë më lehtë për stafin administrativ dhe për vetë drejtorin. Edhe te drejtorët thuhet se i raportojnë Kryetarit, që gjithsesi i raportojnë, por drejtorët i raportojnë Kuvendit dhe Komiteteve.

Kryesuesi – Sqaron se në fund të përshkrimi të detyrave dhe përgjegjësi të drejtorëve shkruan se punët dhe detyrat caktohen me Rregullore, Statut që i ngarkon Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.

Hysni Mjeku – Në mandatet e mëhershme KPF-ja, prej 11 anëtarëve ishte shëndrue në Kuvend, atëherë çfarë efekti kishte me pasë Kuvendi komunal. Në ndërkohë ishte nxjerrë Udhëzimi administrativ që i ka specifikue për çdo Komunë dhe neve, na ka lehtësue sepse sigurisht sot KPF-ja, kishte me i pasë 11 anëtarë, por fatbardhësisht që e ka precizue qartë numrin e anëtarëve për çdo Komunë.

Aziz Bici – Prapë po them se ligji thotë duhet të jemi të përfaqësuar në këto 2 Komitete dhe ne e dimë sa grupe politike jemi këtu, nuk shkon 11 sepse nuk jemi 11, as nuk shkon më shumë se 9. Aleanca që është në pushtet mund ti ketë 2 dhe të tjerët nga një, ose i pari 3, ndërsa të tjerët nga një dhe arrihet numri. Kjo është që don me votue e voton, e nëse nuk don është tjetër gjë.

Lulzim Sadiku – Unë e falenderoj Komisionin për punën që e ka bërë për Statutin e Komunës, që është bërë një punë shumë e mirë nga të gjithë anëtarët e partive politike që kanë marrë pjesë. Edhe në takimin që kemi pasë 2 ditë rresht pa ndalë prej të gjithë kandidatëve, është bërë një punë shumë e madhe. Mendoj dhe ndoshta, nuk është e drejtë që e them këtu, se është dashur ta them edhe atje ku kemi marrë pjesë në takimet 2 ditore, por për shkak për ti ndihmuar Kryetarit, për ti zbritur financat e Komunës, për të funksionuar më lehtë Drejtoritë kërkoj:

- Që të bëhet zvoglimi i Drejtorive, që Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural të kthehet në sektor sepse ka funksionue si sektor dhe ka bërë një punë të mirë si dhe të zvoglohet numri i punëtorëve, të cilët e gjejnë veten në sektor.

- Kërkoj që Drejtoria për infrastrukturë lokale të kalon në DPUKP dhe

- Kërkoj që Drejtoria për mbrojtje të mjedisit të kalon në DKRS.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 5 vota kundër dhe 1 votë abstenim nuk e miratuan Statutin e Komunës së Obiliqit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi –Paraqet raportin e Komisionit komunal sipas vendimit nr.I-170.

a) Raporti nr.X-1054, të dt.04.11.2019 dhe

b) Raporti nr.X-1087, të dt.11.11.2019

Ky është raport informues i Komisionit për ndarjen e bursave për SHM dhe shpenzimet e udhëtimit

Kryetari – E falenderoj Komisionin për një punë aq voluminoze dhe deri më tani nuk kemi pasë asnjë ankesë, por në pikën të ndryshme duhet ta formojmë edhe Komisionin e ankesave, përveç se një numër i aplikuesve për udhëtim dhe për bursa nuk kanë qenë të informuar sipas informative, që i kemi. Mirëpo, është rishpallë përsëri dhe shpresojmë se Komisioni do të vazhdon prapë punën njejtë.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rekomandimet e KPF-së.Tani, kemi rekomandimin për rialokimin e mjeteve dhe për një sqarim më detal fjalën ia jepë drejtoreshës për ekonom dhe financa.

Zarife Behluli – Neve, nga Ministria e financave na ka ardhë emaili se duhet ta bëjmë harmonizimin e pagave për muajin nëntor dhe dhjetor në ato Drejtori komunale, ku ka pasë tepriçë të mjeteve buxhetore është dashur me i mbulue Drejtoritë të cilat kanë pasë mungesa të mjeteve buxhetore, në emër të pagave dhe medijtjeve. Te Drejtoria e inspeksionit kanë qenë 8,566.58 €, dhe këto mjete janë shpërndarë te administrata komunale, te Zyra e Kryetarit dhe te ZKKK-ja, te Prokurimi 13,000 €, te shërbimet kadastrale 10,000 €, te bujqësia 1,172.05. Këto, mjete kanë shkue në Drejtorinë e financave. Te ambienti 23,538.71, dhe këto mjete kanë shkue në Zyren e Kuvendit 9,783.56. Te Drejtoria e infrastrukturës 11,733.36 €, dhe te administrata e shëndetësisë 2,021.79 €. Te Arsimi fillor 61,068.59 €, këto mjete kanë shkue te kujdesi primar shëndetësor 59,208.77 €, dhe te Arsimi i mesëm 1, 859.82 €. Në total transferi i mjeteve është 117,345.93 €.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë abstenim e miratuan vendimin për transferim të mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje.

Kryesuesi – Paraqet 2 kërkesa: 1. Kërkesa nga Pajazit Dedinca, i cili nuk ka arritë të aplikoj për fëmiun e vet me nevoja të veçanta dhe e di se Drejtoria veç e ka rishpallë siq tha edhe Kryetari, kërkesën për rialokim dhe Komisioni me siguri do ta trajton.

2. Kërkesa tjetër është nga kompania Rukolli, drejtuar Drejtorisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural na ka kthye përgjegje dhe kjo përgjegje i kthehet palës.

Pastaj, kryesuesi paraqiti përgjegjet nga kërkesat e mëhershme për emërimin e rrugëve dhe kërkesat tjera.

Kryetari – Propozon të formohet Komisioni për ankesa për ndarjen e bursave.

Enver Gashi – Propozon z. Muhamet Mustafa, për anëtar të Komisionit.

Lulzim Sadiku – Propozon z. Hysni Mjeku, për anëtar të Komisionit.

Kryesuesi – Propozon z. Nazmi Gashi për anëtar të Komisionit.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota për dhe 2 vota abstenim e miratuan themelimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave me këtë përbërje: Muhamet Mustafa, Hysni Mjeku dhe Nazmi Gashi.

Kryetari – Dua ta potencoj edhe çështjen e shpalljes me interes të përgjithshëm publik për parcelën nr.00784/2, që është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar dhe ka të bëjë me rr. "Ali Qerkezi". Kjo rrugë ka filluar të punohet në bashkëpunim me Ministrinë dhe Ministria e infrastrukturës bashkëpunon me 100,000 €, ndërsa pjesën tjetër e mbulon Komuna. Ne kemi vazhdue sipas projektit që e kemi pasë dhe ka situata që po hasim edhe nëpër parcela private. Është edhe një mundësi tjetër që ka qenë një pjesë e një rruge e cila është më e ngushtë se sa që janë në bazë të projektit dhe ka pjesë edhe atje mbi shpronësim. Mirëpo, mbi të gjitha ne kemi negociju me qytetarë dhe aty ku kemi gjetë mirëkuptim i kemi marrë nënshkrimet dhe kemi vazhdue me punimet. Në këtë rast bëhet fjalë për një parcelë që e prekë rrugën dhe meqë është rrugë e interesit komunal, ne mendojmë që të shkohet me shpallje të interesit dhe të vazhdojmë me procedurat e shpronësimit.

Enver Gashi – Ne jemi për këtë shpallje të interesit të përgjithshëm publik.

Lulzim Sadiku – Unë kam kërkuar edhe prej Kryetarit që me u rregullue ajo rrugë sepse është e domosdoshme dhe unë seriozisht jam duke u munduar me i ndihmuar edhe Kryetarit. Mirëpo, më befason ai Komisioni i cili e ka bërë projektin dhe a është marrë masa ndaj përgjegjësve që e kanë bërë këtë gabim. Unë Kryetar po të njoftoj se rruga më e mirë që është bërë prej Plemetinit në Hamidi është nëpër prona komplet të qytetarëve mbi 50 %. Unë po të njoftoj për herë të parë dhe nëse, e dërgon një Komision e vërteton se kjo ka ndodhë, atëherë është mirë me marrë masa ndaj atyre njerëzve, që e kanë bërë dhe që e kanë pranue projektin. Unë kam udhëtue nëpër atë rrugë në kohët më të vështira dhe rruga është e rregulluar si është më së miri, por nuk është në trasenë kryesore që ka qenë rruga Plemetin-Hamidi. Nëse, e marrim kadastrin dhe dalim delë se aty, është punuar nëpër pronat e familjes Shaljani dhe Shehu, që befasoresh. Unë jam pro kësaj rruge dhe jam pro këtij ndryshimi veç le të bëhet rruga e mirë, por mbi të gjitha kërkoj nga Kryetari me marrë masa dhe me ditë pse po ndodhin këto gjëra.

Kryetari – Sa i përket rrugës prej Plemetinit në Hamidi, sipas informatave që ne i kemi nuk prekë prona, por mbi të gjitha do të kërkoj nga DPUKP-ja, që të dalin edhe njëherë ti bëjnë matjet. Mendoj se Komuna në situatat e tilla duhet me i fillue negociatat dhe nuk janë vetëm këto 2 rrugë sepse ne kemi nevojë për shumë

rrugë dhe e dimë se rrugët nëpër lagjet e mbyllura i kanë krijuar vetë banorët. Ne jemi munduar me të praktikë në vazhdimësi që nga ata banorë me marrë nënshkrimin ku ka mirëkuptim dhe me vazhduar me punimet. Mirëpo, ka situata të tilla që jemi të obliguar me hy me shpronësim duke u bazuar se e prekë pronën private dhe nëse, nuk e ka vullnetin me ofruar në shërbim komunal, nëse është rrugë strategjike e domosdoshme për banorët tonë konsideroj se ne duhet të vazhdojmë me procedurën e shpronësimit.

Aziz Bici – Edhe në seancën e kaluar e kemi dhënë kontributin tonë. Ne nuk kemi pasë informacion më heret se është zhvilluar ndonjë debat, se kjo rrugë është e një strategjie të Komunës, qysh tha edhe Kryetari, sidomos kur kërkohet edhe shpronësim i një rruge me standarde çfare po kërkohet. Prandaj, derisa ne nuk kemi qenë pjesë e këtyre debateve, që me pasë informacione të shtuara ne do ta votojmë kundër.

Armend Rushiti – Edhe unë jam për me iu ndihmuar banorëve, por në mënyrë ligjore pa pasë probleme me ligj.

Lulzim Sadiku – Kryetar, nuk jam duke të kundërshtuar, por beso traseja prej Plemetit në Hamidi, delë se nuk është rruga mbi të dhe pse ka ndodhë nuk e di. Mund ti dërgoni ekspertët që pajtohemi plotësisht dhe ajo rrugë shkon në anën e djathtë, që është kthye dhe pse ka ndodhë kjo që po them se do ta vërtetosh vetë kërkohet të merren masa. Nëse, ka shpronësim dhe nëse ka trase që është rruga e gjerë me shkue me u prekë ndoshta pa dashje, pa qëllim, nuk po paragjykoj, vetëm seriozisht ka me dalë kjo që po e them.

Kryetari – Unë po e marrë për obligim se do ta dërgojmë gjeodetin atje, i cili e merrë gjendjen faktike dhe besoj se në mbledhjen e radhës ju njoftojmë.

Muhamet Mustafa – Kryetar, nuk di sa je i informuar se unë në mbledhjen e kaluar këtë propozim të Drejtorisë së infrastrukturës, e kam kundërshtuar duke e dhënë arsytimin tim me fakte, me hartë ku shihet në gjeoportale se ekziston një rrugë në anën e majtë të pjesës ku është propozuar për shpronësim. Tash, nuk dua të japë arsytim përsëri sepse nuk kam besue se kjo çështje prapë delë në rend dite. Mirëpo, dua të bëjë një pyetje se arsytimi i drejtorit për infrastrukturë ka qenë se gjatë zhvillimit të punimeve në rrugën “Ali “Qerkezi, kemi hasë në një parcelë private, për të cilën është bërë propozim. Pas kësaj parcele ekziston edhe një parcelë tjetër për me dalë në rrugën ekzistuese Plemetin, që është e asfaltuar përafërsisht sa hapërisa e kësaj sale të Kuvendit. Tash, çka do të ndodhë, prapë haset në ato pengesa, si do të vepron Drejtoria apo Komuna në këtë çështje.

Kryetari – Mendoj se të gjitha rrugët që janë të nevojshme duhet të përmbyllen, të kryhen sidomos një rrugë që konsideroj se është rrugë strategjike për neve sepse komplet Qyqavica, apo komplet ajo zonë në pa nevojë me hy në Obiliq psh me shkaktoje komunikacion, ose në kushte të jashtëzakonshme të dimrit munden me shfrytëzuar pa problem andej. Tani, janë 2 çështje ne po e prekum një pronë private dhe po e prekum një pronë të KBI-së, që besoj se me KBI-në do të krijohet mundësia e negocijimit sepse është hapësirë e vogël. Nëse, nuk kanë me pranuar ata çështjen e negocijimit që me ofruar në shërbim duhet edhe atë pjesë pastaj me inicuar përmes AKP-së, për me të shpronësimit.

Kryesuesi – Paraqet propozim vendimin e Kryetarit për shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në Plemetin.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 12 vota për, 2 vota kundër dhe 3 vota abstenim e miratuan vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Plemetin.

Pika e 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit të marrë të mëhershëm për emërimin e rrugës me emrin “Mulla Xhemajli” sepse duhet të përfshihet edhe Ligji për emërimin e rrugëve.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota përmiratuan vendimin për kërkesën e banorëve të Obiliqit të vjetër për emërimin e rrugës me emrin “Mulla Xhemajli” (Kod i ri).

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit të marrë të mëhershëm për emërimin e rrugës me emrin “Sejdi Gërvalla” sepse duhet të përfshihet edhe Ligji për emërimin e rrugëve.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 17 vota përmiratuan vendimin për kërkesën e banorëve të fshatit Raskovë për emërimin e rrugës me emrin “Sejdi Gërvalla” (Kod i ri).

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për shfuqizimin e vendimit nr.I-171, të dt.24.09.2019, për aprovimin e Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Kryetari – Ju e dini se ne në vitin e kaluar i kemi nda 300,000 €, për subvencionim të energjisë dhe qëllimi ka qenë i mirë prej të gjithë neve, se në dëm të asaj që po na bën KEK-u, të krijohet një mundësi që edhe me energji të bëhet një subvencionim. Ne në vazhdimësi me Ministrinë e zhvillimit ekonomik dhe Ministrinë përkatëse, kemi kërkuar që ata me i bë Udhëzimet administrative, por fatkeqësisht asnjë Ministri nuk i ka bërë deri më tani dhe tash ne nuk mund ta implementojmë për shkak të moskryerjes së detyrave të Ministrive përkatëse. Unë e falenderoj grupin punues sepse qëllimi është i gjithëanshëm që këtë benefit krahas subvencioneve tjera, të përfitojnë qytetarët. Në të ardhmen duhet ti shohim procedurat dhe mundësinë qysh me realizue, por është vështirë. Unë konsideroj se ju takon qytetarëve tonë dhe ne duhet të bëjmë përpjekje me gjetë rrugë.

Aziz Bici - Unë do të votoj kundër shfuqizimit të këtij vendimi dhe ju bëj thirrje të gjithë anëtarëve që ta votojnë kundër për vetëm një arsye që Komisionet dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse, të kenë kujdes që kur e sjellin një vendim për me votue, ne duhet të konsultohen me ligjin sepse nuk ka seancë që nuk po kërkohet prej neve shfuqizimi i vendimeve.

Armend Rushiti – Pyeti se a do të marrim prapë vendim, apo vetëm do ta shfuqizojmë.

Kryesuesi – Sqaron se ne duhet ta shfuqizojmë vendimin, por nuk mund të nxjerrim Rregullore pa e harmonizue Ministria me një Udhëzim administrativ.

Muhamet Mustafa – Pyeti se a duhet të shfuqizohet edhe formimi i Komisionit që ka qenë, apo është diçka tjetër ajo çështje.

Kryesuesi – Përgjegjet jo.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota për dhe 2 vota kundër e miratuan Shfuqizimin e vendimit nr.I-171, të dt.24.09.2019, për aprovimin e Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Nazmi Gashi – Unë para 2 muajve, e kam dërgue një skicë urbane dhe ju më keni thënë me ia bë një kërkesë Drejtorisë për infrastrukturë, që me punue projektin.Unë e falenderoj drejtorin e infrastrukturës që e ka pranue kërkesën time dhe është punue një projekt shumë profesional dhe i detalizuar. Projekti është bërë sepse ka qenë i nevojshëm dhe tani ai projekt është i gatshëm. Mirëpo, ne kemi qenë në telashe se e kemi pasë një rast vdekje por s’kemi vend ku me i pritë njerëzit për të pame. Pra, objekti për të pame, shiritat e gjelbërimit dhe është fusha sportive, kështu që kërkoj nga drejtori i infrastrukturës që projektin të ia dorëzoj Kryetarit. Unë e kam dhënë edhe njoftimin në lagje se e vetmja lagje në Sibofc, është që kanë mbetë banorët mbi 80 % dhe nuk janë dislokue, që do të thotë se e meriton me pasë një përkujdesje për ata.

Armend Rushiti – Herën e fundit në mënyrë gojore ia kam bërë një kërkesë drejtorit z.Naim Miftari, lidhur me vendosjen e policëve të vdekur në fshatin Bakshi. Aty, janë 2 rrugë që vozitet me shpejtësi të madhe dhe përgjegjia e tij ka qenë se ka mungesë të stafit dhe pyetja ime është se a ka mundësi të gjendet ndonjë mënyrë tjetër të vendosen policët e shtrirë që të mos ndodhin aksidentet. Unë kam një pyetje për drejtorëshën e shëndetësisë, e posaqërisht për Kryetarin, se ne të gjithë e dimë se kemi bërë zhurmë të madhe kur kemi mbajtë seancë të jashtëzakonshme lidhur me punësimet në KEK dhe nuk kemi arritë asgjë. Në anën tjetër ne jemi vetë ata që nuk po e respektojmë Ligjin për Obiliqin. Unë po flas lidhur me një konkurs të fundit që u shpallë nga Drejtoria e shëndetësisë, ku është pranuar një mjek, por jo nga Komuna e Obiliqit, edhe pse ne kemi këtu, mjekë që udhëtojnë deri në Han të Elezit, është fjala për mjeken Bedrije Kozmaqi dhe kemi vllaun që punon ende me kontratë përmes karitasit. Pse, po ndodhë kjo te na kur ne kemi mjekë tonë, ndërsa punësojmë mjekë tjerë, jashtë Komunës tonë.

Aziz Bici – Unë i kam 2 çështje për fshatin Mazgit dhe për fshatin Plemetin, fjala është për rr.”Halil Bici” në Mazgit të Epërm. Unë personalisht kam qenë i habitur nga fakti se qysh papritur as s’kam parë se aty është duke u prishë rruga e vjetër me qëllimin që të shtrohet rruga e re. Kjo ka fillue me 200-250 metërshin e parë prej magjistrales Prishtinë-Vushtrri dhe unë nuk e di se ka pasë ndonjë kërkesë nga ndonjë qytetarë

më heret, ose nëse ka pasë nuk ka asgjë zyrtare sa kam unë informacion. Në Mazgitin e Epërm në gjendje të mjerueshme është oborri i shkollës në përgjithësi, që shpresoj se keni qenë me vizitue dhe e keni parë. Prandaj, në mes të 2 prioriteteve do të duhej të ishte shkolla, e jo rruga e cila do të ishte e shfrytëzueshme me më pak mjete, që do ti mbulonte gropat. Mirëpo, nëse papritmas është marrë një vendim i tillë unë pres që ju të shpalosni projektin në atë rrugë që keni nisur. Unë pres të na informoni se a përfshin ndërtimin e rrugës dhe rindërtimin e kanalizimit të ri, ujësjellësit të ri megjithëse që të dyja kanë qenë funksionale. E vetmja gjë që ka mungue është trotuari, prandaj a përfshin plani i tanishëm i ndërtimit trotuarin dhe cilat do të jenë standardet e kësaj rruge të re. Në fshatin Plemetin me dt.23 nëntor kemi pasë një debat ku kemi qenë të ftuar të gjithë Kryetarët e degëve të subjekteve politike në Obiliq, Kryetari i Komunës dhe policia.

Çështjet kryesore ishin mbipopullimi paradoksal në fshatin Plemetin, për çka banorët e fshatit shpreheshin shumë të shqetësuar se kjo mund të bëjë rrezik në njëfarë forme edhe për sigurinë e tyre. Qytetarët në Plemetin, madje kanë bërë edhe një peticion të nëshkruar nga 145 qytetarë, ku theksohen shqetësimet e tyre për këtë mbipopullim paradoksal nga komunitetet tjera. Ndërsa, tash shqetësimi im i përsëritur në vazhdimësi është fakti se si ju nuk ju përgjegjieni shqetësimeve të qytetarëve. Pastaj, shqetësim tjetër është se si këta njerëz po vijnë heshturazi, kush janë këta njerëz, prej nga vijnë, cili është motivi që të vendosen në masë aq të madhe të koncentruar vetëm në fshatin Plemetin. Unë e falenderoj z.Slavisa, që ma ka kthye një përgjegje përveç disa informacioneve të përgjithshme, që i vlerësoj shumë. Unë e përkrahu fuqimisht që të gjithë banorët e Komunës së Obiliqit, të cilët janë jashtë Kosovës të kthehen këtu. Mendoj se nataliteti nuk është as te shqiptarët, as në përgjithësi dhe këtu flitet për dhjetëra shtëpi të ndërtuara në fshatin Plemetin. Aty flitet se paslufte kanë qenë 300 shtëpi, banorë të fshatit Plemetin, ndërsa tash është folë mbi 700 shtëpi të ndërtuara, do të thotë gjithsejt përfshirë edhe ato në fshatin Plemetin. Pyetja ime për z.Slavisa është se këtu, a është fjala vetëm për shtëpitë që posedojnë leje ndërtimi, apo është fjala edhe për ato shtëpi që nuk posedojnë leje ndërtimi.

Kryetari – I përgjegjem z.Nazmi Gashi, se besoj që drejtori do ta bën planifikimin dhe do ta shohim në fillim të vitit të ardhshëm, mundësi buxhetore ka dhe shpresoj se do të kryhet si projekt. Sa i përket policëve të shtrirë në Bakshi, drejtori veç e mori mesazhin dhe shpresoj se do të vepron. Ndërsa, për çështjen e mjekëve e di se prioritet gjithëherë kanë qytetarët e Komunës së Obiliqit, por mbi të gjitha imponime në konkurse nuk mund të ketë derisa ka të Obiliqit. Edhe në këtë drejtim mund të shohim për me ju dhënë sqarim. Në Plemetin debati ka qenë i ftuar për javën e kaluar z.Aziz, dhe ne kemi shkue, por nuk ka qenë askush, ndërsa për këtë javë ju e dini se ka qenë i planifikuar takimi me anëtarë të Kuvendit dhe Ekzekutiv për çështjen e Statutit dhe normal që s'kemi mund me marrë pjesë. Sa i përket çështjes së ndërtimit, ju e dini se kemi marrëveshje me BE-në dhe me Ministrinë për kthim, kështu që të gjithë banorët që shprehin dëshirë për rikthim ne jemi të gatshëm me iu përgjegjë. Tash, a është shumë, apo pak mbipopullu Plemetini, mendoj se nuk është faji ynë se duhet me pa varësisht prej kërkesave sepse nesër mund të mbipopullohet edhe Obiliqi. Mirëpo, ne duhet me kontrollue që mos me pasë ndërtime pa leje. Memorandumet që janë të lidhura me IOM-in dhe BE-në, mendoj se nëse përfitojnë qytetarët tonë, ata janë të Komunës tonë, pse jo. Te rr."Halil Bici" ne i kemi diskutue në fillim projektet dhe nëse ju kujtohet e kemi pasë një punëtori në Shqipëri ku i kemi nxjerrë projektet për të gjitha rrugët dhe po mundohemi të gjitha ti realizojmë. Pastaj, ka qenë kërkesë e qytetarëve dhe unë personalisht kam marrë pjesë në një debat në shkollë dhe mund të ju sjellim nënshkrimet e pjesëmarrësve në atë takim. Kërkesa ka qenë për ujërat atmosferike që kanë problem të vazhdueshëm te Prestreshët këtu, poshtë dhe lartë atje. Unë sa e di është kërkesa prej qytetarëve për rr."Halil Bici" dhe nuk është bërë heqja e asfaltit pa ndonjë nevojë, por ju e dini sa ka qenë e dëmtuar ajo pjesë. Konsideroj se dëmtimet e mëdha që janë shkaktue nëpër trup të rrugës, nuk është problemi te asfalti, por te nënasfalti. Nëse, ndërtohet trotuari, nëse trajtohen edhe ujërat atmosferike, ka kërkesa edhe për gyp të ujësjellësit, kështu që ne do të mundohemi të jemi në shërbim të qytetarëve për kërkesat që janë. Nëse, doni mund ta organizojmë një takim në lagjen tuaj prapë, i thirim qytetarët nëse thojnë atë pjesë e përmbyllim ndërsa pjesën tjetër nuk e punojmë hiç. Mirëpo, unë e di se është kërkesë mbi 90 %, të asaj zone për shkak të ujërave atmosferike e kanë një problem tepër serioz dhe për shkak të trotuarit dhe rrugës së dëmtuar.

Aziz Bici –Sa i përket mbipopullimit në fshatin Plemetin, ne të gjithë i njohim banorët e fshatrave tona ku kemi lind dhe jemi rritë, sigurisht se edhe z.Slavisa i njehë banorët në fshatin e vet. Mendoj se sipas ligjit që është përmendë fjala është për banorët të cilët kanë qenë të fshatit Plemetin, në këtë rast. Pyetja ime është a keni një listë të banorëve të këtij fshati që i kemi ende jashtë Komunës dhe jashtë Kosovës. Në rast se e dimë edhe sa familje kanë mbetë pa u kthye, mendoj se nuk është sekrete, nuk dua me ditë me emra e mbiemra, por me ditë numrin e familjeve, që gjenden jashtë Kosovës. Në rast se ne e dimë për këtë, atëherë çdo gjë është në rregullë, ndërsa po të shkohet kështu për mua është e paqartë do të thotë te fshati Plemetin. Sa i përket fshatit Mazgit, unë jam prej atij fshati, nuk kemi kohë të mjaftueshme me bisedue mjaftueshëm me bashkëfshatarë sepse aty, ka nevojë në rast se ndërtohet trotuari është dashur me bisedue me ata që dikush ndoshta, me lëshue rrugë. Dikush ndoshta edhe e ka zënë rrugën dhe ne këtë informacion është dashur paraprakisht me pasë. Askush nuk është kundër dhe është e vërtetë se në 2 vende ka qenë keq, te Fehmi Durmishi, aty që është ndërprerë për shkak të ujit që janë lidhë dhe këtu afër nënkallimit, do të thotë autostrada që kalon ka pasë gropa. Ndërsa tjetërkund nuk ka pasë gropa në këtë segment ku ka fillue. Unë thashë se prioritet i prioritetëve ka qenë oborri i shkollës dhe unë i kam edhe fotografitë këtu, beso kaq vite me qenë oborri i shkollës në këtë gjendje është e tmerrshme. Mendoj se nuk është dashur as me folë për rrugë, e lëre më edhe për rrethojë që ju e dini se është e domosdoshme që shkolla ta ketë një rrethojë dhe ju e dini se shkolla nuk ka rrethojë.

Kryetari – Sa i përket çështjes së rrugës ekzistojnë edhe fotografitë dhe dëshmitë, ndërsa te çështja e prioritetëve pikërisht në këtë sallë kur e ke kundërshtue buxhetin të kam thënë z.Aziz, a ke ndonjë projekt për fshatin Mazgit, dhe asnjë projekt nuk e ke sjellë, por gjithëherë i ke kundërshtue dhe je duke i kundërshtue. Disa shkolla janë trajtue në këtë vit dhe disa do të trajtohen në të ardhmen, janë ndërtue sallat e edukatës fizike në Obiliq dhe Milloshevë, janë ndërtue edhe anekse e shkolla të reja, që dikush me dashje apo pa dashje po mundohet me i dhënë karakter tjetër. Unë prapë ju lus, të gjitha projektet që planifikoni që janë me prioritet ne vendbanimet, lagjet, qytetin kudo që ne jetojmë sjellni të mundohemi me i planifikue vitin e ardhshëm. Rruga "Halil Bici" është shumë e domosdoshme sepse kanë problem me ujëra që e dini edhe ju vetë. Ne shpesh kemi thënë dhe kemi kërkuar falje edhe te qytetarët se për shkak të punimeve mund të kufizohen lëvizjet e automjeteve, por do të mundohemi të paktën me qenë të kalueshme dhe mos me shkaktue pengesa.

Aziz Bici – Kryetar, buxheti nuk mund të votohet kjo po më pëlqen, e kjo s'po më pëlqen, por buxheti votohet si tërësi dhe është e vërtetë se unë kam thënë jam kundër këtij projekti dhe jam për këtë projekt. Unë si tërësi kam pasë vërejtje tjera ndaj buxhetit, prandaj nuk mund ta lidhni me projekte të caktuara votimin kundër buxhetit.

Kryetari – Ja, ku i ke të gjithë kolegët në sallë të Kuvendit, nuk e kam potencue. Të gjithë anëtarët e Kuvendit që vlerësoni për projekte sjellni, famirësisht buxhet ka dhe i planifikojmë. Rruga "Halil Bici" është kërkesë e qytetarëve që konsideroj se është e drejtë, ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe duhet me ua ofrue qytetarëve. Nëse, e ke sjellë si projekt ideor, apo e ke dhënë si ide se duhet me ndërtue një projekt cilido qoftë ai, trego cili është ai që ne nuk e kemi respektue.

Aziz Bici – Kryetar, a bon me ditë kush e ka bërë kërkesën, sepse unë kërkoja atë ditë edhe prej drejtorit z.Fatmir Bërbatovcit, që ne të kemi bashkëpunim prej fshatit. Është përmendë psh emri i Lutfi Durmishit dhe unë e takova atë i cili më tha se nuk kam bërë kurrfarë kërkesë dhe neve, na është thënë prej Kuvendit komunal, prej njerëzve se a doni me ua shtrure rrugën. Mendoj se është mirë të bashkëpunojmë sepse unë nuk jam kundër atij aktivisti të juaj, ose të fshatit sepse punon në interes të fshatit. Unë po them se vërtetë është tmerr me pa gjendjen e oborrit të shkollës, këtë jam duke e thënë.

Kryetari – Sqaron se në shkollë kanë qenë Prestreshët, Raqët, Durmishët, gjithë ajo zonë andej dhe e kemi mbajtë një takim në shkollë.

Nora Preniqi – Qytetarët të gjithë kanë qenë sepse konkretisht te familja e Jahja Prestreshit, konkretisht te prindi im, aty gjithmonë uji e ka marrë krejtë pjesën e oborrit dhe të pjesës së jashtme. Për këtë ka qenë e domosdoshme, jo vetëm të prindit tim por të gjithë Prestreshëve, prej Pollatëve deri te rruga e Jahës, e ka

marrë uji krejtë atë pjesë. Për këtë ka qenë e domosdoshme për me rregullue pjesën e ujërave të shiut dhe kjo është rregullue falë intervenimit të Komunës. Besoj se rruga është e domosdoshme me u renovue, ose me u ndërtue, por sigurisht edhe shkolla. Mirëpo, rruga është mbi të gjitha sepse ajo rrugë i dërgon fëmijët në shkollë.

Aziz Bici – Është e vërtetë, se është sanue përkohësisht nga uji i të reshurave dhe sot uji nuk tubohet. Nëse, nuk gaboj është bërë një marrëveshje në mes të banorëve dhe Kuvendit komunal sepse aty është bërë vetëm një intervenim me beton të hapur lartë. Ndërsa, në të ardhmen marrëveshja ishte që të futet brenda dhe të shfrytëzohet hapësira e kanalit me trotuar dhe kjo është për me vlerësue. Mendoj se për kaq vite rresht që është prishë ku kanë qenë toaletet e vjetra dhe nuk është largue materiali, është komplet tubë dhe është dëmtue aty Shtëpia e shëndetit. Nëse, vërtetë ka banorë që nuk e cakton këtë prioritet, ku te ne fëmijët qe sa vite shkojnë vazhdimisht në oborr të shkollës pa rrethojë, ne e dijme se një oborr i pastër ndikon edhe në edukim dhe në çdo drejtim.

Kryetari – Më erdhi mirë që pranove se ka pasë debat me qytetarë dhe është kërkesë e qytetarëve. Unë edhe më heret e përmenda edhe për rr.”Halil Bici” që i prekë pronat private dhe e përmenda se DPUKP-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë e infrastrukturës, që i kanë mbledhë nënshkrimet për gatishmërinë e tyre me ofrue atë pronë private që është prekë në shërbim të vetvetes, në shërbim të qytetarëve për me u ndërtue trotuari. Nëse, ka projekt, ka ide prapë po e them se ne si Ekzekutiv duhet me ofrue në shërbim të qytetarëve dhe besoj se edhe ajo shkollë do të trajtohet siç janë trajtue edhe shkollat tjera.

Fatmir Bektashi – E kam një kërkesë prej disa banorëve të fshatit Breznicë, për vendosjen e një pasqyre në një rrugë e cila nuk ka emër, por dalja prej rrugës anësore në kyqjen në kryesore është shumë keq. Unë do të ia definoj saktë drejtorit z. Naim Miftari, se ku gjendet kjo rrugë.

Armend Rushiti – Kryetari, më heret tha se nuk e din se kush është pranue si mjek në Komunën e Obiliqit dhe për këtë duhet me pyet drejtoreshën e shëndetësisë, ose Nënkryetarin dhe e shohim se a është nga Komuna e Obiliqit, apo jashtë Komunës.

Kryetari – Ju, nuk e keni problem me shkuje dhe me marrë pjesë në Komision edhe kur bëhet përzgjedhja. Nëse, ju të gjithë anëtarët e Kuvendit, jeni të gatshëm dhe keni kohë jeni të mirëseardhur te unë për me i vizitue projektet. Poashtu, nëse jeni të gatshëm mund të dalim dhe shikojmë se cilat janë prioritetet nëse, jeni të gatshëm me marrë pjesë nëpër Komisione, në cilësinë e vëzhguesve pa asnjë problem.

Armend Rushiti – Ky tash që është punësue si mjek në Komunën tonë, është jashtë Komunës dhe këtë duhet me ditë Kryetari, ose Nënkryetari, ose drejtori i shëndetësisë. Ne jemi për Ligjin për Obiliqin i cili ia jepë të drejtën banorit të Komunës tonë, e jo të Komunës tjetër.

Kryetari – Edhe ju si mjek jeni pranue këtu, por shkon në Mitrovicë. Ju mund të merrni informata nga Drejtoria dhe shikoj dokumentet e Komisionit, për këtë çështje.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se 2 herë ka konkuru, 2 herë është pranue dhe e din shumë mirë që është pranue, por personat që nuk kanë konkurre s’mund ti pranojmë.

Hysni Mjeku – Meqë jemi në prag të festës së madhe të 28 Nëntorit dhe që është shpallë nga Kryeministri si festë shtetërore gjegjësisht kombëtare, lus Drejtorinë komunale për Arsim dhe kulturë të na njoftoj se çka është ndërmarrë në këtë drejtim.

Kryetari – Përgjegjet se Komisioni është duke punuar dhe shpresoj se me dt.28 ftesat do të jenë nëse, nuk gaboj në ora 5 është tubimi qëndror ndërsa, aktivitetet si zakonisht fillojnë edhe më heret. Unë shfrytëzoj rastin të ju uroj të gjithëve, festat dhe njëkohësisht ju ftoj që të jeni pjesë e festës së 28 Nëntorit.

Arbnore Nasufi – Kërkoj sqarim nga Drejtoria e Arsimit, apo nga ju lidhur me disa kërkesa që i ka bërë SHF ”Pandeli Sotiri” qysh në muajin qershor. Mirëpo, deri më tani nuk kam parë se është arritë një punë të bëhet aty si izolimi i kulmit, që është e domosdoshme mos me pritë deri në këtë kohë sepse fillojnë reshjet. Pra, dua sqarim nga Drejtoria e Arsimit, pse nuk është punuar në atë drejtim. Kërkesa tjetër është rregullimi i pompave të ujit, nxemjes qëndrore të shkollës, që edhe ajo deri para një jave kur ne kemi mbajtë mbledhje si Këshill i shkollës, nuk është rregullue. Pastaj, rregullimi i rrymës, këto kutiat e siguresave janë të domosdoshme të rregullohen. Poashtu, edhe shkolla amë në Plemetin e ka të nevojshme ta ketë oborri i

shkollës një rrethojë sepse siç jam e informuar nga prindërit mësimi nuk mund të mbahet nga zhurmat dhe tubimet e njerëzve aty, nga komunitetet e ndryshme. Kërkoj nga ju dhe Drejtoria të ndërmarrin masa për me u rregullue këto gjëra.

Kryetari – Përgjegjet sa e di unë renovimet janë në proces dhe ende nuk janë përmbyllë nëpër shkolla. Sa i përket çështjes së pompave ato janë funksionale, por ka dyshim se mund të ketë telashe dhe faktikisht sot e ka shprehë këtë shqetësim edhe drejtori, janë në proces të tenderimit që me pasë mundësi me i zëvendësue. Në Plemetin, ka qenë një projekt bashkë me Ministrinë e kulturës, që është dashur të ndërtohet një fushë sportive, por për shkak të buxhetit që ata ende nuk e kanë alokue ne s’kemi mund ta nënshkruajmë kontratën. Mbetemi me shpresë se edhe ajo do të përmbyllet si proces.

Xhezide Dragusha – Unë i kam disa vërejtje të vogla në fshatin Palaj, është një pusëtë e hapur afër rrugës kryesore te Palaj-Lajthishtë, që paraqet rrezik për fëmijët parashkollor e tutje sepse është pusëtë e hapur dhe nuk ka kapak. Prandaj, kjo çështje është urgjente të rregullohet. Vërejtje tjetër e imja është meqë rrugët janë punue të gjitha mbeturinat aty, janë hudhë mbi një shtëpi, që banorët nuk janë këtu dhe ajo pjesë mirëmbahet nga një punëtor aty. Kërkoj që ato të hiqen sa më shpejt.

Aziz Bici – Pyetja ishte a mundem ta presë një listë për banorët, jo vetëm për fshatin Plemetin, por edhe për Palaj, Baimoc, Milloshevë, për të gjitha fshatrat e Komunës tonë, se sa familje i kemi jashtë Kosovës dhe që pritet me u kthye.

Kryetari – Përgjegjet se shefi i ZKKK-së, nuk është këtu por aty është një Komision që i pranon kërkesat e qytetarëve dhe është një numër bukur i madh i të interesuarve të rikthehen në Komunën tonë. Shpresoj se në mbledhjen e ardhshme, ose që doni me pasë më heret mundeni me adresue me shkrim dhe te zyra pritëse mundesh me marrë numrin.

Mbledhja përfundoi në ora 14:42’


Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.11.2019, në orën 9:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Enver Gashi (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK), Qendresa Dubova (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatos Kurshumlija (LDK), Fatmir Bekteshi (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Lulzim Sadiku (PDK), Hysni Mjeku (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Dragan Dancetovic (SL).

Munguan: Linda Sadiku, Samire Berisha dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkryetar i Komunës për komunitete, drejtorët komunal, përf. e OSBE-së, përf. i IZHL-së.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Situata e krijuar pas tërmetit në Republikën e Shqipërisë

Kryesuesi – Fillimisht i ftoi të pranishmit për 1' heshtje në shenjë nderimi të viktimave të shkaktuara nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë.

Pas nderimit me 1'heshtje kryesuesi ndër të tjera tha se duke parë gjendjen pas dt.26 nëntorit dhe tërmetet që janë në vazhdimësi që prekën territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pjesët e Kosovës, ne në bashkëpunim me Kryetarin dhe shefat e kemi organizue këtë mbledhje të jashtëzakonshme.

Kryetari – Të nderuar, tani më situata për të gjithë neve është e qartë dhe besoj se edhe ju me shqetësim jeni duke i përcjellë zhvillimet që po ndodhin atje. Ne si Komunë jemi mundue që vazhdimisht ta përcjellim situatën dhe poashtu, kemi bisedue edhe me drejtorin e QKMF-së, që kanë ofruar gatishmëri nëse, kërkohen 2 autoambulanca dhe komplet ekipin me dërgue atje, por një kërkesë të tillë ende nuk e kemi pasë. Pastaj, jemi mundue me iu bashkue edhe iniciativave tjera, të organizuara nga shoqëria civile. Ne si Kuvend komunal jemi konsultue me Ministrinë e financave, MAPL-në dhe me DEFZH-në, për çështjen e ligjshmërisë dhe kemi marrë një konfirmim se nga vija e mallrave dhe shërbimeve dhe nëse kemi nga vija e subvencioneve me ndihmue si Komunë, aq sa kemi mundësi. Ne kemi menduar që ti ndihmojmë në vlerën prej 15,000 €, dhe për këtë jemi konsultuar me kryesuesin dhe shefat e grupeve parlamentare.

Enver Gashi – Sot jemi tubue këtu, për një katastrofë që ka ndodhë në Shqipëri dhe secili duhet ta ndjejmë një obligim aq sa kemi mundësi me kontribue në këtë rast sepse këto fatkeqësi natyrore, mund të na ndodhin edhe neve. Unë jam i pajtimit që ti ndajë 15,000 €, por meqë i kemi edhe 2 viktima të rinjë nga Gjilani, të cilët e kanë gjendjen e vështirë materiale propozoj të shtohet edhe një shumë e mjeteve prej Komunës. Nëse, nuk kemi mundësi nga Komuna t’iu ndihmojmë këtyre 2 familjeve, atëherë vullnetarisht secili prej neve, aq sa kemi mundësi do t’iu ndihmojmë.

Fatos Kurshumlija – Pajtohem se duhet me ju ndihmue dhe me votue këtë shumë të mjeteve, vetëm se me pyet drejtoreshën e financave nëse, ka mundësi që këtë shumë me rritë në 20,000 €, sepse disa Komuna tjera, që janë më të vogla se ne si Deqani ose Juniku, nuk e di saktë kanë vepruar në këtë drejtim. Tash, ne si Komunë për kokë banori jemi më të pasur në nivel të Kosovës, nëse na lejon Ministria e financave dhe ka buxhet Komuna, të paktën me rritë këtë shumë të mjeteve. Poashtu, e përkrahu iniciativën e z.Enver Gashi, për ndihmë familjeve në Gjilan, nëse ka mundësi Komuna mirë e nëse, jo atëherë ne individualisht si Kuvend komunal, do të ndihmojmë.

Lulzim Sadiku – Vërtetë, është një rast i dhembshëm dhe pajtohem me propozimin për shumën e mjeteve mjeteve për 15,000 €, dhe njëkohësisht pajtohem edhe me z.Enver Gashi, që nëse ka mundësi Komuna, ti përkrahim edhe 2 familjet, që u çekën më heret. Mirëpo, nëse nuk ka mundësi Komuna e përkrahu çështjen që të participojmë në mënyrë individuale. Unë jam pro kërkesës edhe për Shqipëri dhe për këto 2 familje, që janë në Kosovë.

Aziz Bici – Ne e përkrahim shumën e mjeteve prej 15,000 €, dhe poashtu, e përkrahim edhe propozimin e z.Enver Gashi. Mirëpo, mundësisht në ditët në vijim duhet të shihen se a ka edhe mundësi tjera, që ta përcjellim gjendjen nga afër dhe çka mund të ndihmojmë.

Armend Rushiti – Edhe ne e përkrahim vendimin e Komunës, për ndarjen e këtyre mjeteve dhe iniciativën e z.Enver Gashi, për përkrahjen e atyre familjeve që janë nga Gjilani.

Nazmi Gashi – Ju njoftoj se unë kam qenë në kontakt me grupin e inxhinjerëve dhe tash po kërkohen inxhinjerë të rinjë dhe nëse, ka kuadro të reja munden me ju bashkangjitë.

Dragan Dancetovic – Duboko zalimo za sve poginule, razumemo strah i neizvesnot gradjana Albanije.Ovde smo da im pokazemo da razumemo njihovu patnju, damo ohrabrenje id a povredjenima zelimo sto brze ozdravljenje. Slazem se za svaku novcanu pomoc koju mozemo da im pruzimo, da pokazemo das mo humani i ocekujem da cemo danas biti jednoglasni, jer ovde je u pitanju humanist da se ne delimo na politicke stranke i neke politicke stavove da zastupamo.

Kryesuesi – Meqë, mbledhja është thirrë pas situatës së krijuar në Shqipëri mundësitë buxhetore janë që Kuvendi me marrë vendim për 15,000 €.

Zarife Behluli – Ne jemi konsultue dhe kemi vendosë me iu nda mjetet në vlerën prej 15,000 €, për të prekurit nga tërmeti në Republikën e Shqipërisë, ndërsa për rastin në Gjilan, ashtu si ua merrë mendja veproni.

Labinot Mirena – Propozon që 15,000 €, të shkojnë në Shqipëri, ndërsa ne si Komunë është mirë ti ndajmë 5,000 €, për 2 familjet nga Gjilani, secilës nga 2,500 €.

Kryetari – Mendoj se ndoshta, kishte me qenë mirë që ndarja e mjeteve në shumën prej 15,000 €, për Republikën e Shqipërisë, të jetë përmes ambasadës dhe Ministrisë së punëve të jashtme. Ndërsa, pjesa tjetër meqë, kanë shprehë vullnet shumë zyrtarë komunal me ndihmue me aq sa kanë mundësi propozoj të formohet një Komision, ose një grup që me i mbledhë ato mjete dhe me i dërgue atje.

Fatmir Bekteshi – E përkrahu idenë e Kryetarit për formimin e një Komisioni që ne të participojmë me aq sa kemi mundësi, pastaj t’iu dërgojmë mjetet atyre familjeve dhe t’iu shprehim ngushllime.

Aziz Bici – Mendoj se edhe Qeveria e Kosovës i ka nda 20,000 €, për këto 2 familje, sa i kam përcjellë mediat dhe shpresoj se ato mjete janë dorëzue. Propozimi im është që deri në seancën e ardhshme Ekzekutivi të ketë kohë me shqyrtue edhe njëherë mundësinë me bë ndarje për 2 arsye. Kjo nga fakti se

po kërkohet me marrë iniciativë sot dhe gjatë këtyre ditëve besoj se ka shumë edhe këtu, që jemi angazhues dhe kemi dhënë aq sa kemi mund dhe mundësitë janë mjaft të vogla që me u mbledhë një shumë dhe me i ndihmue familjet. Ndërsa, deri në muajin e ardhshëm edhe në rast se nuk mundet me nda mjete Komuna prej buxhetit, atëherë ne në muajin e ardhshëm mund të ndajmë diçka sepse nuk jam i sigurtë se të gjithë i kemi mundësitë për me dhënë nga se gjatë këtyre ditëve kemi shpenzue.

Kryesuesi – Unë e shohë gatishmërinë e juve për solidaritet, për këtë dhembje për popullin shqiptar në Shqipëri, që e bashkëndejmë të gjithë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuann vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumën prej 15,000 €, ndihmë financiare dhe të dëmtuarve me rastin e tërmetit në Republikën e Shqipërisë.

Kryetari – Propozon të formohet Komisioni për mbledhjen e mjeteve buxhetore për ndihmë 2 familjeve, të dëmtuara nga fshati Livoç, Komuna e Gjilanit.

Enver Gashi – Propozon z.Labinot Mirena, për anëtar të Komisionit.

Kryesuesi – Propozon z.Fatmir Bekteshi dhe Fatos Kurshumlija për anëtarë të Komisionit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal unanimitisht e miratuan themelimin e Komisionit për mbledhjen e mjeteve buxhetore, për ndihmë 2 familjeve të dëmtuara nga fshati Livoç, Komuna e Gjilanit me rastin e vdekjes së 2 anëtarëve të tyre në tërmetin e dt.26 Nëntor 2019, në Republikën e Shqipërisë me këtë përbërje: Labinot Mirena, Fatmir Bekteshi dhe Fatos Kurshumlija

Mbledhja përfundoi në ora 9:30'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri